



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 31 gusht 2021

Njoftim për shtyp

Zhvillimet më të rëndësishme në institucionet tjera financiare^{1,2} (ITF): tremujori i dytë i vitit 2021

- **Totali i mjeteve të institucioneve tjera financiare (ITF), në tremujorin e dytë të vitit 2021 arritën në 152.572 milionë denarë dhe u rritën për 6,363 milionë denarë në bazë tremujore.** Në kuadër të strukturës të mjeteve të ITF, fondet e pensionit vazhdojnë të kenë pjesën më të madhe prej 65,92%, pasuar nga mjetet e kompanive të sigurimeve me një pjesëmarrje prej 18,9%.
- Këtë tremujor, vazhdoi trendi i rritjes së totalit të mjeteve të institucioneve tjera financiare (ITF), të cilët shënuan një rritje tremujore dhe vjetore prej përkatësisht 4,4% dhe 16,8%. Mjetet e fondeve të pensionit janë bartës kryesor i zhvillimeve pozitive në bazë tremujore dhe vjetore të totalit të mjeteve të ITF, me një kontribut shtesë edhe të nënsektorëve tjerë të ITF.

Tabela 1. Totali i mjeteve/detyrimeve të ITF³

	Кв.2 2020	Кв.1 2021	Кв.2 2021	Квартални промени		Годишни промени		Структура (Вкупно ОФИ)
				Кв.2 2021/Кв.1 2021		Кв.2 2021/Кв.2 2020		
	Состојби, во милиони денари			МИЛИОНИ денари	%	МИЛИОНИ денари	%	%
1. Останати финансиски институции	130,589	146,209	152,572	6,363	4.4	21,983	16.8	100
1.1 Осигурителни друштва	27,342	27,644	28,824	1,180	4.3	1,482	5.4	18.9
1.2 Пензиски фондови	81,548	94,888	99,423	4,535	4.8	17,875	21.9	65.2
1.3 Инвестициски фондови	9,585	9,660	10,087	427	4.4	502	5.2	6.6
1.4 Други ОФИ	12,114	14,016	14,238	222	1.6	2,124	17.5	9.3
1.4.1 Финансиски друштва	4,411	5,726	5,873	148	2.6	1462	33.1	3.8
1.4.2 Лизинг друштва	5,959	6,401	6,478	78	1.2	519	8.7	4.2
1.4.3 Друштва за управување со пензиски и инвестициски фондови	1,743	1,890	1,887	-4	-0.2	143	8.2	1.2

Burimi: BPRMV.

¹ Institucionet tjera financiare përfshijnë: fondet e investimeve, fondet e pensioneve, kompanitë e sigurimeve, kompanitë e menaxhimit të fondeve të investimeve dhe kompanitë e menaxhimit të fondeve të pensioneve, kompanitë financiare dhe kompanitë ofrues të lizingut financiar.

² Në gusht të vitit 2018, të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2018 janë korrigjuar në mënyrë që të zbatohet metodologjia e re në pajtim me Manualin e ri dhe Udhëzimin e ri për statistika monetare dhe financiare të FMN-së nga viti 2016. Dy ndryshime janë thelbësore. I pari i referohet ndryshimit në trajtimin e instrumenteve financiare të shprehura në „denarë“ me klauzolë valutore, të cilat në pajtim me metodologjinë e re, nga kategoria „denarë“ rishpërndahen në kategorinë „valutë e huaj“. Ndryshimi i dytë është në paraqitjen e zhvlerësimit të instrumenteve financiar, i cili në vend të kapitalit paraqitet brenda kategorisë „detyrime tjera“. Për më shumë informacione shihni në vijim:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija_za_promeni_vo_monetarnata_statistika_mk.pdf

³ Për qëllimet e këtij njoftimi, kategoria „ITF-të tjera“ përfshinë: kompanitë e menaxhimit të fondeve të investimeve dhe kompanitë e menaxhimit të fondeve të pensioneve, kompanitë financiare dhe kompanitë ofrues të lizingut financiar.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- **Pjesa më e madhe e mjeteve të ITF** janë investime në letra me vlerë të borxhit⁴ (pjesëmarrje prej 49,1%), letra vetanake me vlerë (pjesëmarrje prej 24,6%), si dhe valuta dhe depozita (pjesëmarrje prej 12,5%). Pjesa më e madhe e **detyrimeve të ITF rrjedh nga rezervat teknike të sigurimit**⁵, si dhe llogarive kapitale⁶ (pjesëmarrje prej përkatësisht 56,2% dhe 35,3%).

Tabela 2. Mjete/detyrime të ITF, sipas nënsektorëve dhe sipas instrumenteve financiare, T. 2 2021

	Вкупно ОФИ		Пензиски фондови		Осигурителни друштва		Инвестициски фондови		Други ОФИ	
	состојба (во мил. ден.)	учество (во %)	состојба (во мил. ден.)	учество (во %)	состојба (во мил. ден.)	учество (во %)	состојба (во мил. ден.)	учество (во %)	состојба (во мил. ден.)	учество (во %)
Вкупни средства	152,572		99,423		28,824		10,087		14,238	
Валуте и депозити	19,089	12.5	8,507	8.6	6,260	21.7	3,288	32.6	1,033	7.3
Хартии од вредност различни одакци	74,859	49.1	59,268	59.6	11,723	40.7	2,940	29.1	929	6.5
Кредити	10,234	6.7	0	-	180	0.6	8	0.1	10,046	70.6
Акции и останат сопственички капитал	37,478	24.6	31,605	31.8	1,931	6.7	3,835	38.0	106	0.7
Технички резерви на осигурување	2,265	1.5	0	-	2,265	7.9	0	-	0	-
Финансиски деривати	0	-	0	-	0	-	0	-	0	-
Останати средства	5,642	3.7	44	0.0	5,033	17.5	15	0.1	550	3.9
Нефинансиски средства	3,004	2.0	0	-	1,430	5.0	0	-	1,574	11.1
Вкупни обврски	152,572		99,423		28,824		10,087		14,238	
Кредити	7,417	4.9	0	-	0	0.0	0	-	7,417	52.1
Технички резерви на осигурување	85,747	56.2	68,386	68.8	17,361	60.2	0	-	0	-
Финансиски деривати	0	-	0	-	0	-	0	-	0	-
Останати обврски	5,599	3.7	166	0.2	3,063	10.6	77	0.8	2,293	16.1
Капитални сметки	53,809	35.3	30,872	31.1	8,399	29.1	10,009	99.2	4,528	31.8

Burimi: BPRMV.

- **Sipas instrumenteve**, rritja tremujore dhe vjetore e mjeteve të ITF rrjedh nga investimet më të larta në letra me vlerë të borxhit dhe letra vetanake me vlerë. Në anën e detyrimeve, llogaritë kapitale dhe rezervat teknike të sigurimeve kanë kontribut më të madh drejt rritjes në bazë tremujore dhe vjetore.



⁴ Letrat me vlerë të borxhit (LVB) u referohen letrave me vlerë të ndryshme nga aksionet sipas klasifikimit ndërkombëtar të instrumenteve financiare, siç është botuar në bilancet dhe pasqyrat e institucioneve tjera financiare.

⁵ Rezervat teknike të sigurimeve përmbajnë: kapitali neto i amvisërive nga rezervat e sigurimit të jetës dhe sigurimi jo-jetë.

⁶ Llogaritë kapitale përfshijnë: investimet e kapitalit, fitimet e pashpërndara, fitimi i vitit aktual, rezerva e përgjithshme dhe e veçantë dhe rezerva rivlersimi.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



Burimi: BPRMV.

Zhvillimet më të rëndësishme në ITF, sipas llojit të institucioneve

- Në tremujorin e dytë të vitit 2021, **totali i mjeteve të фондеве të пенсионит (të detyrueshme dhe vullnetare)**, janë më të larta për 4,8% në bazë tremujore dhe 21,9% në bazë vjetore. Sipas instrumenteve, rritja tremujore dhe vjetore është rezultat i investimeve më të larta në letra me vlerë të borxhit, gjatë një kontributi pozitiv edhe të investimeve të letrave vetanake me vlerë, në kushte të rrënies së valutave dhe depozitave. Në anën e detyrimeve, rritja në të dyja bazat del nga rritja e rezervave teknike dhe llogarive të kapitalit, të cilat pothuajse kanë kontribut të njëjtë.




Burimi: BPRMV.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në fund të muajit qershor të vitit 2021, **totali i mjeteve të kompanive të sigurimeve**⁷ u rritën për 4,3% dhe 5,4% në nivel tremujor dhe vjetor, kryesisht si rezultat i investimeve në letra me vlerë të borxhit. Në rritjen tremujore kontribut shtesë patën edhe llogaritë e arkëtueshme dhe rezervat teknike të sigurimeve, kurse në rritjen vjetore kontribut pozitiv kanë edhe letrat vetanake me vlerë. Në anën e detyrimeve, nxitësi kryesor i rritjes tremujore janë rezervat teknike të sigurimeve, me kontribut më të vogël pozitiv edhe të llogarive kapitale, ndërsa nxitësi kryesor i rritjes vjetore janë rezervat teknike të sigurimeve.



- **Totali i mjeteve të фондеve të investimit**^{8,9}, në tremujorin e dytë të vitit 2021 shënojnë një rritje tremujore prej 4,4%, me kontribut dominant ndaj rritjes së investimeve në letra vetanake me vlerë. Rritja vjetore është 5,2% dhe kryesisht rrjedh nga rritja e investimeve në letra vetanake me vlerë dhe letra me vlerë të borxhit, në kushte të zvogëlimit të valutave dhe depozitave. Në anën e detyrimeve, rritja tremujore dhe vjetore në tërësi është rezultat i rritjes së llogarive kapitale.


⁷ Në BPRMV aktualisht raportojnë gjashtëmbëdhjetë kompani sigurimesh të cilat janë në regjistrin e Agjencisë për Mbikëqyrje të Sigurimeve (ASO), prej të cilave njëmbëdhjetë janë për sigurim jo-jetë dhe pesë janë për sigurim jete.

⁸ Regjistri i Komisionit të Letrave me Vlerë (KLV) aktualisht përfshin gjashtëmbëdhjetë фонде të hapura të investimit dhe njëmbëdhjetë фонде private të investimit, me ç'rast në BPRMV raportojnë njëzet e katër фонде.

⁹ Deri në tremujorin e dytë të vitit 2021 në seritë e të dhënave janë përfshirë dy фонде të reja të investimeve.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



Burimi: BPRMV.

- **Këtë tremujor, totali i mjeteve të nënsektorëve të tjerë të ITF^{10,11,12}** shënojnë rritje tremujore dhe vjetore prej përkatësisht 1,6% и 17,5%. Në fund të muajit qershor të vitit 2021, aktiviteti huadhënës i kompanive financiare dhe lizing kompanive arriti 10.030 milionë denarë dhe shënoi rritje tremujore prej 3,3%. Rritja tremujore është kryesisht rezultat i aktivitetit huadhënës së lizing kompanive, si dhe i huadhënies së rritur nga ana e kompanive financiare. Rritja vjetore prej 23,5% para së gjithash është rezultat i rritjes së huadhënies së kompanive financiare. Tek detyrimet, rritja tremujore në masë të madhe është rezultat i rritjes së llogarive kapitale, ndërsa rritja vjetore përveç rritjes së llogarive kapitale është edhe si rezultat i detyrimeve të rritura në bazë të kredive.



Burimi: BPRMV.

¹⁰ Duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2014, përfshihen të dhëna mbi raportimin e kompanive financiare dhe kompanive ofrues të lizingut financiar. Të dhënat aktualisht mbulojnë njëzet e katër kompani financiare dhe shtatë kompani ofrues të lizingut financiar

¹¹ Në tremujorin e katërt të vitit 2017, në seritë të të dhënave është përfshirë një kompani e re financiare (një shtëpi kursimi e cila është reregjistruar në kompani financiare), ndryshim i cili kishte ndikim mbi normat vjetore të ndryshimit.

¹² Deri në tremujorin e dytë të vitit 2021 në seritë e të dhënave janë përfshirë dy fonde të reja të investimeve.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Rishikim i të dhënave

Të dhënat për zhvillimet në ITF në këtë njoftim përmbajnë korigjim të të dhënave për periudhën prej tremujorit të dytë të vitit 2020 deri në tremujorin e parë të vitit 2021, me qëllim të marrjes së informacioneve të reja, të korigjuara dhe të dhëna nga raportuesit. Këto korigjime nuk shkaktuan ndryshime të konsiderueshme në të dhënat e publikuara paraprakisht dhe kryesisht vijnë nga përmirësimi i mbulimit dhe cilësisë së raportimit.

Informacione shoqëruese

Të dhënat e serive kohore: Të dhëna tremujore për mjetet dhe detyrimet e institucioneve financiare <http://nbrm.mk/ns-newsarticle-bilans-i-pregledi-na-finansiskite-institucii-kvartalnipodatoci.nspix>

Shpjegime metodologjike:

http://nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjija/Metodologjija_monetar_na_07_2018_mak.pdf

Informacion për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesit:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija_za_promeni_vo_monetarnata_statistika_mk.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

http://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf

Të dhëna tremujore për mjetet dhe detyrimet e institucioneve financiare: 30 nëntor i vitit 2021 (mesatare referuese me tremujorin e tretë të vitit 2021).

Për pyetje gazetarësh, ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 116 (ose 112/110/108).